

VENDIM
Nr. 232, datë 12.9.2022

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E LICENCIMIT TË SHOQËRISË
“BREÇANI R.O.S.P.” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “DRITA” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1980 kw**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 144/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1528/1 prot., datë 8.9.2022, “Mbi një ndryshim në vendimin e licencimit të shoqërisë ‘Breçani R.O.S.P.’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Drita’, me kapacitet të instaluar 1980 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 09, datë 21.1.2022, ka licencuar shoqërinë “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Drita”, për një afat 30-vjeçar. Ndër të tjera ky vendim përcakton kushtet, si vijon:

“2. Shoqëria “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k. duhet të paraqesë në ERE çdo vit kontratën nr. 2693/5 prot., datë 18.7.2018, të rinovuar, brenda datës 18 gusht të çdo viti, deri në përfundim të afatit 10-vjeçar që ajo përcakton.

4. Shoqëria “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k. të depozitojë në ERE certifikatën e pronësisë për tokën shtet, me kartelën shoqëruese, me shënimin përkatës për zonën që do të jetë në përdorim të shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë së HEC “Drita”, jo më vonë se një muaj nga pajisja me këtë dokument.”.

- Në kuadër të plotësimit të këtyre kushteve, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 37/3 prot., datë 28.7.2022, duke i kërkuar informacion.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 37/4, datë 4.8.2022, ka përcjellë shkresën me të cilën i është drejtuar Bashkisë Tropojë, në lidhje me mosrinovimin e kontratës së qirasë për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullosor, për arsye se shoqëria ka përmbushur gjithë detyrimet kontraktore.

- Po ashtu, shoqëria ka bërë me dije se gjurma e projektit të hidrocentralit shtrihet në dy zona kadastrale me nr. 1133, fshati Begaj, dhe nr. 3404, fshati Shoshan, Bashkia Tropojë, në pasuritë me status juridik shtet.

- Për gjithë sa më sipër, duke qenë se nuk njihemi ende me ndonjë komunikim të Bashkisë Tropojë, në lidhje me përfundimin e kontratës së qirasë për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor, nr. 2693/5 prot., datë 18.7.2018, të lidhur ndërmjet Bashkisë Tropojë në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, me objekt lejimin e hapjeve të kanaleve, shtrirjen e tubacionit dhe të drejtën e kalimit dhe përdorimit në funksion të ndërtimit të HEC “Drita”, me qëllim për të sqaruar çështjen e rregullimit pronësor në tërësi, vlerësojmë që afati i parashikuar në pikën 2 të vendimit të licencimit nr. 09, datë 21.1.2022, të ndryshohet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 9, datë 21.1.2022, ndryshon si vijon:

“2. Shoqëria “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k. duhet të paraqesë në ERE kontratën nr. 2693/5 prot., datë 18.7.2018, të rinovuar, apo çdo dokument tjetër që i shërben realizmit të saj brenda 30 ditëve pune nga marrja dijeni.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Breçani R.O.S.P.” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti